

NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË PARË PUBLIK

Përmbaryesi Privat **Atip Mustafa**, më datë 23.08.2021 ka sjellë Konkluzion mbi shitjen e paluajtshmërisë për lëndën **P.nr.13/21**, e hipotekuar në favor të bankës BKT. Ngastra kadastrale me numër **P-70202003-00014-0**, me sipërfaqe prej 2820 m², Zona Kadastrale Vushtrri, e evidentuar në emër të pronarëve Kadri Hasani, Sami Hasani dhe Sami Hasani, e bllokuar/hipotekuar në favor të kreditorit Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.

Kjo pasuri e përshkruar më lartë do të shitet përmes Ankandit të Parë Publik, në mbështetje të plotë të dispozitës së Nenit 227 të LPP-së, me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përmbushur detyrimet që debitori Fitim Hasani B.I. ka ndaj kreditorit – **Banka Kombëtare Tregtare Kosovë SH.A.**

» Vlera e paluajtshmërisë është vlerësuar në shumën prej: **81,000.00 €** (tetëdhjetë e një mijë) Euro, pasuri e cila në ankand të parë të shitjes publike mund të shitet nën vlerën e përcaktuar, por jo nën 50% të vlerës së përcaktuar.

■ Data e Ankandit të Parë Publik: **27.09.2021**

■ Koha e shitjes – ora: **10:30**

■ Vendi i shitjes: **Përmbaryesi Privat Atip Mustafa, Adresa: Rr.Dëshmorët e Kombit, Ndërtesa MBC, Kati II, Vushtrri.**

Të gjithë të interesuarit duhet të deponojnë tek Përmbaryesi Privat shumën prej 10 % të vlerës së cekur të paluajtshmërisë por jo më shumë se 5,000 Euro në emër të kaucionit, para se të fillojë shitja, por jo më vonë se data 26.09.2021, me të drejtë të kthimit të kaucionit pas përfundimit të ankandit, ofertuesve të pasuksesshëm.

Për informata me të hollësishme, ju lutem, kontaktoni në tel: 038 666 666; 045/700-790;

Prishtinë, 2021



038 666 666 | www.bkt-ks.com

Ne jemi gjithmonë këtu!